

UDHËZIM
Nr. 14, datë 23.12.2024

PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 23, DATË 9.12.2014, “PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE”, I NDRYSHUAR

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 23, datë 9.12.2014, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, pika 10, paragrafi 10.8, “Të tjera”, pas kategorisë 38, shtohet kategoria 39, me përmbajtje si më poshtë vijon:

1. “ *Kategoria 39. Nxënës që mëson profesionin, që ndjek arsimin dhe formimin profesional në kualifikimet e niveleve 2 deri në 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, në formën e dyfishtë dhe që ka lidhur një kontratë pune për mësimin e profesionit.*”

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj